

VENDIM
Nr.1391, datë 17.10.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I I SEGMENTIT
RRUGOR MILOT-RRËSHEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronari, që shpronësohet, Fejzulla Musli Saraçi, të kompensohet në vlerën plotë, për objektin, me numër pasurie 3/111, në zonën kadastrale 2963, me vlerë 3 030 097 (tre milionë e tridhjetë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 487 000 (katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera totale e shpronësimit, 3 030 097 (tre milionë e tridhjetë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të fillojë më 20.10.2008 dhe të përfundojë më 30.12.2008.
 7. Pronari të kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarit, brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe planimetrisë përkatëse.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha